



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

për vizitën në Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë

Për: Z. Xhelal Sfeçla, Ministër
Ministra e Punëve të Brendshme

Z. Valon Krasniqi, Drejtor
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim

Z. Fehmi Rama, zëvendësues i Udhëheqësit
Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë

Kopje: Z. Habit Hajredini, Drejtor
Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 16 prill 2025

Hyrje

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm: MKP) vizitoi Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë, më seli në Vranidoll të Prishtinës.

Qëllimi i vizitës

1. Qëllimi i vizitës në Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të migrantëve nga autoritetet e Republikës së Kosovës, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
2. Vizita u realizua së bashku me Komisaratin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe më Programin për të Drejtat Civile në Kosovë (CPRK), më të cilët Avokati i Popullit ka marrëveshje bashkëpunimi.

Përbërja e grupit monitorues

3. Grupi monitorues i MKP-së përbëhej nga një këshilltare juridike për parandalim të torturës dhe një këshilltare-punëtore sociale, dy përfaqësues nga CRPK-ja dhe një përfaqësues nga UNHCR-ja.

Bashkëpunimi

4. Gjatë vizitës, bashkëpunimi i zëvendësuesit të Udhëheqësit të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrantë (me tej: QPPM) ishte i nivelit të lartë. Ekipi pati qasje në të gjitha hapësirat e Qendrës të cilën e vizitoi. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësua qasja në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe intervistimi i migrantëve të pranishëm.

Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë

5. QPPM-ja u themelua me Vendim Nr. 0490/2022, të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), datë 24 qershor 2022. Ndërsa funksionimi i QPPM-së është i rregulluar me *Rregulloren (ZKM) Nr. 03/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme.*¹
6. Sipas paragrafit 1.1 të nenit 23A të Rregullores (ZKM) Nr. 03/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr.01/2021² për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, potencohet se QPPM-ja ofron pritjen, strehimin, akomodimin, informatat dhe mbështetjen emergjente për migrantët e parregullt. Ndërsa në paragrafin 1.2 potencohet: “*Qendra e Pritjes së Përkohshme përkujdeset për kushtet, mbrojtjen dhe mirëqenien e migrantëve sipas legjislacionit në fuqi.*” Po ashtu, paragrafi 1.3 thekson: “*Qendra e Pritjes së Përkohshme kryen identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të migrantëve të cenueshëm, viktimave të mundshme të trafikimit me qenie njerëzore dhe të miturve të pashoqëruar.*”

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71783>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=71783>

7. Sipas Vendim Nr. 0490/2022 të MPB-së, QPPM-ja funksionon përkohësisht si Njësi Organizative Ekuivalente me Divizionin, në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, të MPB-së. QPPM-ja ka funksion pritjen dhe akomodimin e migrantëve (24 orë në ditë, 7 ditë në javë) me status të parregullt në territorin e Republikës së Kosovës.
8. Po ashtu, sipas vendimit të lartcekur, MPB-ja duhet të miratojë Udhëzues për funksionimin e rregullave të brendshme të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrantë.
9. Ligji për të Huaj, i cili është në plotësim-ndryshim, pasi të hyjë në fuqi, do ta lehtësojë funksionimin e Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrantë.

Procedurat e pranimit

10. Në paragrafin 6 të Vendimit Nr. 0490/2022 të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB)³, të datës 24 qershor 2022, potencohet se pranimi, regjistrimi, profilizimi dhe referimi i migrantëve për në QPPM bëhet nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: DMH). Pra, pas pranimit dhe regjistrimit nga DMH-ja dhe lëshimit të vërtetimit, akomodimi i migrantëve bëhet nga zyrtarët e QPPM-së.

Të drejtat e migrantëve në QPPM

11. Migrantët e akomoduar në QPPM kanë të drejtë për ndihmë mjekësore, ndihmë juridike falas, të drejtën e përkrahjes psiko-sociale, sipas nevojës, të drejtën e përkthyesit në gjuhën amtare të migrantit apo në gjuhën të cilën ai e kupton, të drejtën e kryerjes së riteve fetare, të drejtën për aktivitete sportive, të drejtën për qasje në internet 24/7, si dhe të drejtën për të parashtruar ankesë tek udhëheqësi i QPPM-së, lidhur me kushtet e akomodimit dhe sjelljet e zyrtarëve të kësaj qendre.
12. MKP-ja vërejtë se secili migrant e nënshkruan Deklaratën, përmes së cilës njoftohet për të drejtat e tij dhe përgjegjësitë. Deklarata është në tri gjuhë: arabe, angleze dhe shqipe.

Njoftimi për të drejtat e tyre themelore

13. Udhëheqësi i Qendrës i njofton migrantët e akomoduar për të drejtat dhe detyrimet tyre, për mundësinë e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare, kthimin në vendin e origjinës, ndihmën juridike falas si dhe këshillime të tjera të nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.
14. Po ashtu, MKP-ja vërejtë se migrantët informohen për të drejtat e tyre edhe nëpërmjet broshurave dhe dokumenteve të shkruara në gjuhën arabe, angleze, frënge, turke, serbe etj. Përveç kësaj, në korridoret e QPPM-së janë të vendosura korniza të mëdha, ku nëpërmjet tyre migrantët informohen për të drejtat e tyre në gjuhën shqipe, angleze dhe arabe.
15. Po ashtu, zyrtarët e Organizatës Joqeveritare “Programi për të Drejtat Civile në Kosovë” (CRPK) janë të pranishëm në QPPM dy herë në javë, duke u ofruar migrantëve ndihmë juridike falas, duke i njoftuar për të drejtat e tyre si dhe për qëllim të nevojave të tyre angazhon edhe përkthyes të gjuhës arabe.

³ Vendimi Nr.0490/2022, datë 24 qershor 2022.

Trajtimi

16. Gjatë vizitës, ekipi i MKP-së intervistoi migrantët e pranishëm, ku asnjëri nga ta nuk pohoi se u keqtrajtua, por të gjithë nga të intervistuarit pohuan se janë duke u trajtuar mirë në QPPM.
17. Sipas raportit vjetor, nga 1 janari deri me 31 dhjetor 2024 kanë qenë 802 migrantë, prej tyre 20 fëmijë të grup-moshave nga 0-18. Kryesisht migrantët kanë qenë nga Maroku, Siria, Egjipti, Algjeria, Palestina, Afganistani dhe Iraku. Mesatarja e qëndrimit të migrantëve në QPPM është 7 ditë, maksimumi që mund të qëndrojnë është deri në 15 ditë.

Kushtet e akomodimit në QPPM

18. Gjatë vizitës në QPPM, ekipi i MKP-së vërejti se kapaciteti i kësaj qendre ishte për 55 persona. Ndërsa kushtet e akomodimit ishin në nivelin e kënaqshëm. QPPM-ja ishte e ndarë në dy blloqe, Blloku A - që shërbente për akomodimin e burrave beqarë, ndërsa, Blloku B - shërben për familjet dhe grupet e cenushme, dhe dy dhoma të qëndrimit ditor, në cilat ka edhe TV të instaluar me kabllor, si dhe hapësira e brendshme dhe e jashtme e QPPM-së është e mbuluar me Wi-Fi.

Ushqimi

19. Migrantëve u ofrohet ushqim nga operatori ekonomik i kontraktuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Për këtë çështje, udhëheqësi i QPPM-së paraqiti shqetësimin e tij se për të nuk ofrohet ushqim edhe pse është i vetmi punëtor në QPPM. Udhëheqësi pohoi se nuk do ta kishte problem të blinte ushqim, mirëpo QPPM-ja është në kilometrin e 14 të magjistrales Prishtinë - Podujevë, në fshatin Vranidoll, dhe është vështirë të bëhet zgjidhja për ushqim. Lidhur me këtë çështje, udhëheqësi i QPPM-së bëri kërkesë në MPB, por ende nuk mori përgjigje. **MKP-ja inkurajon Ministrinë e Punëve të Brendshme që ta sigurojë një shujtë ushqimore edhe për udhëheqësin e QPPM-së.**

Kujdesi shëndetësor

20. MKP-ja vërejti se shërbimet mjekësore për të huajt në këtë qendër ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare më e afërt dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Ndërsa Shërbimi i Refugjatëve Jezuit (JRS) ofron barna farmaceutike falas për migrantët, kurse shërbimet psikologjike u ofrohen nga organizata joqeveritare "Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës" (QKRMT).
21. Lidhur me shërbimet mjekësore, udhëheqësi i QPPM-së pohoi se kanë nevojë për të paktën një infermier për dhënien e terapisë si dhe ofrimin e ndihmës së parë mjekësore për emigrantët, pasi ai nuk është i thirrur për këtë punë dhe mund të konsiderohet shkelje.

Fëmijët

22. Gjatë vitit 2024 ka qenë i akomoduar një fëmijë i moshës nga 0-13 vjeçar, ndërsa nga grup-mosha 13-14 vjeçare kanë qenë 20 fëmijë/të mitur. Sipas udhëheqësit të QPPM-së, të miturit e pashoqëruar intervistohen në prani të punëtorit social, i cili vjen nga Komuna e Mitrovicës Veriore. Fëmija i pashoqëruar më pastaj vendoset në QPPM, së bashku me familjarët e tyre apo me personat e afërt me të cilët kanë migruar.
23. Udhëheqësi i QPPM-së pohoi se lidhur me kategoritë e cenushme, si të miturit e pashoqërueshëm dhe viktimat mundshme të trafikimit me qenie njerëzore, nuk kanë

ndonjë trajnim apo udhëzues për kushtet e pritjes dhe vlerësimin e nevojave për këtë kategori.

Kontaktet me botën e jashtme

24. Migrantët kanë të drejtë të dalin në ajër të pastër si dhe nga QPPM-ja në qytet, nga ora 7:00 deri në orën 22:00. Ndërsa gjatë kohës së qëndrimit në QPPM, ata mund të zhvillojnë aktivitete sportive, kulturore apo fetare etj.
25. Migrantët kur dalin jashtë hapësirave të QPPM-së evidentohen në regjistrat hyrje-dalje. Pas kthimit, ata kontrollohen nga zyrtarët policorë.
26. Migrantët po ashtu vizitohen edhe nga Komisariati i Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), si dhe organizatat e ndryshme joqeveritare si CRP/K, QKRMT. Po ashtu Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë qasje dhe komunikim të pakufizuar me migrantët në QPPM.

Procedura e parashtrimit të ankesave

27. Migrantët kanë të drejtë t'i parashtrojë ankesë udhëheqësit të QPPM-së, lidhur me kushtet e pranimit dhe të trajtimit të tyre në këtë qendër. Po ashtu, në dispozicion të migrantëve në QPPM është një kuti e ankesave e vendosur nga vetë kjo qendër, ku migrantët mund t'i vendosin ankesat e tyre. Migrantët, ankesat e tyre mund t'i shprehin edhe para përfaqësuesve të UNHCR-së dhe organizatave joqeveritare.
28. Gjatë vizitës, MKP-ja u shpërndau migrantëve broshura në gjuhën arabe, serbe dhe angleze, të cilat hollësisht sqarojnë mandatin e MKP-së dhe të Avokatit të Popullit, si dhe mënyrën se si të kontaktojnë me MKP-në dhe me IAP-në. Po ashtu atyre u sigurohet qasje e papenguar në organizatat ndërkombëtare dhe në OJQ-të vendore.

Personeli i QPPM-së

29. Gjatë vizitës, MKP-ja vërejti se stafi i QPPM-së tash për tash është i përbërë vetëm nga udhëheqësi i QPPM-së. Pra, në QPPM punon vetëm udhëheqësi i kësaj qendre, i cili merret me të gjitha punët e QPPM-së, edhe pse sipas paragrafit 4 të nenit 23A të Rregullores për Funkcionimi e Qendrës (ZKM) Nr. 03/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme⁴, parashihet që numri i të punësuarve në QPPM të jetë tre (3). Udhëheqësi pohoi se ka bërë kërkesa të vazhdueshme për plotësimin e stafit sipas rregullores, mirëpo një gjë e tillë nuk është realizuar nga MPB-ja deri më tani.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

30. Avokati i Popullit, bazuar në të gjeturat nga vizita, konstaton se QPPM-ja nuk ka staf të mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të migrantëve të akomoduar në QPPM.
31. Avokati i Popullit konstaton se QPPM-ja nuk posedon Udhëzues për funksionimin e Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrantë, sipas Vendimit Nr. 0490/2022, të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, datë 24 qershor 2022.
32. Avokati i Popullit konstaton se në QPPM ka nevojë për angazhimin e të paktën një infermieri për dhënien e shërbimeve mjekësor për migrantët e akomoduar në QPPM.

⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71783>

33. Po ashtu, Avokati i Popullit konstaton se ka nevojë për trajnime për stafin dhe të tjerët në fushën e migrimit, në mënyrë që migrantët të trajtohet sipas praktikave standarde ndërkombëtare.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës në QPP, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Punëve të Brendshme:

- *Të punësojë staf në Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë, sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme.*
- *Të miratojë Udhëzuesin për funksionimin e rregullave të brendshme të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrantë, sipas Vendimit Nr. 0490/2022, të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, datë 24 qershor 2022.*
- *Ta angazhojë një infermier për nevojat mjekësore për migrantët në Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë.*
- *Të organizojë trajnime të nevojshme në fushën e migrimit, pasi Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë është vija e parë për strehimin e migrantëve.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit